



Republika e Kosovës

Republika Kosova/ Republic of Kosovo

Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

KPK/ Nr.388/2022

Datë: 16 mars 2022

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 7 paragrafit 1 nën paragrafit 1.25 të Ligjit Nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, nenit 12 paragrafit 5 të Ligjit Nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 12 të Rregullore Nr. 05/2019 për Procedurën Disiplinore të Prokurorëve, në takimin e mbajtur me datë 16 mars 2022, nxjerr këtë:

VENDIM

- I. Themelohet Paneli Hetimor i Këshillit Prokurorial të Kosovës për hetimin e rastit disiplinor AD.nr.02/2022 ndaj një prokurori në Prokurorinë Themelore në Prishtinë, në këtë përbërje:
 1. Afrim Shefkiu, Prokuror në Prokurorinë Speciale – Kryesues;
 2. Naim Abazi, Prokuror në Prokurorinë Speciale – Anëtar;
 3. Nijazi Rexha, Prokuror në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë – Anëtar.
- II. Paneli Hetimor do të ketë anëtarët rezervë në këtë përbërje:
 1. Ersan Qavolli, Prokuror në Prokurorinë Themelore në Pejë;
 2. Petrit Kryeziu, Prokuror në Prokurorinë Themelore në Prizren.
- III. Obligohen anëtarët e Panelit Hetimor nga pika I dhe II e këtij vendimi që detyrat dhe përgjegjësitë e tyre t'i ushtrojnë në bazë të legjislacionit në fuqi.
- IV. Obligohet Sekretariati që këtë Vendim ta publikojë në ueb portalin e sistemit prokurorial të Republikës së Kosovës.
- V. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

Jetish Maloku

Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës

T'i dërgohet :

- Anëtarëve të Panelit Hetimor;
- Sekretariatit të KPK-së;
- Arkivit të KPK-së;